



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
REKTORATI

Nr 276/1 Prot.

Vlorë më, 23.02.2022

VENDIM

Nr. 2, datë 23. 02. 2022

PËR

MIRATIMIN E PROJEKT BUXHETIT TË VITIT BUXHETOR 2022

Në mbështetje të nenit 40, të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Rektorati, në mbledhjen e datës 23. 02 .2022

VENDOSI:

1. Miratimin e projekt buxhetit të UV-së për vitin 2022, bashkëlidhur dokumenti i projekt buxhetit me sugjerimet e mëposhtme:
2. Shpërndarjen në mënyrë të barabartë në vlerën e 500.000 lekë për çdo Fakultet të vlerës së përgjithshme 2.000.000 lekë, të parashikuar për financimin e kërkimeve shkencore (miniprojekteve).
3. Nga vlera 7.066.185 lekë e parashikuar në projekt buxhet për vitin 2022 për akreditimin e programeve të studimit Cikli i Dytë i studimeve (MP dhe MSH) të financohen si më poshtë:
 - a. Mbështetje financiare për akreditimin e programeve të studimit Master Profesional në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, Fakultetin e Ekonomisë dhe në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, gjatë vitit 2022.
 - b. Mbështetje financiare për akreditimin e programeve të studimit Master Shkencor dhe Master Profesional në Fakultetin e Shëndetit Publik, gjatë vitit 2022.
 - c. Mbështetje financiare sipas kërkesave të Fakulteteve për karrige, tavolina etj.
 - d. Mbështetja financiare për Masterat Shkencor të Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore, Fakultetit të Ekonomisë dhe të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë të realizohet në vitin buxhetor 2023.
3. Ngarkohet Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse të përllogarisin ndryshimet e sugjeruara si më sipër të cilat të pasqyrohen në dokumentin e projekt buxhetit që do t'i përcillet Senatit Akademik.
4. Vendimi i përcillet për procedurë të mëtejshme Senatit Akademik, së bashku me projekt buxhetin bashkëlidhur dhe konkretizimin e sugjerimeve të mësipërme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. ROLAND ZISI

